



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 173

Tiranë – E premte, 26 shtator 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator..... 21903
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin..... 21904
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin..... 21904
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 25.9.2025	Për lirim nga detyra..... 21906
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 25.9.2025	Për emërim në detyrë..... 21907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 25.9.2025	Për lirim nga detyra..... 21907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 25.9.2025	Për emërim në detyrë..... 21907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 25.9.2025	Për emërim në detyrë..... 21907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 25.9.2025	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj..... 21908

**VENDIM****Nr. 521, datë 25.9.2025****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT DHE
KRYENEGOCIATOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator është drejtimi teknik i negociatave dhe bashkërendimi i brendshëm i procesit të përgatitjeve të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zhvillimit të procesit teknik të negocimit, plotësimit nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të kushteve dhe kriterëve për mbylljen e negociatave dhe anëtarësimit, nismave për integrimin e përshpejtuar, bashkërendimit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, bashkërendimit të prioritetëve, hartimit dhe propozimit të politikave, në kuadër të procesit të anëtarësimit, bashkërendimit të kuadrit strategjik të lidhur me anëtarësimin, zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së performancës për arritjen e rezultateve, si dhe informimit të publikut për këto procese, integrimi në Bashkimin Evropian, si dhe bashkërendimi i konsultimeve me biznesin dhe grupet e interesit në çështjet për integrimin evropian.

3. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Bashkërendon procesin e brendshëm të përgatitjeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

b) Bashkërendon prioritetet e politikave shtetërore dhe politikëbërjen, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

c) Bashkërendon, harton politikat dhe kuadrin strategjik, në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin

Evropian dhe i bën propozime Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave;

ç) Koordinon punën e grupit negociator të Republikës së Shqipërisë për plotësimin nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të kushteve dhe kriterëve për përmbylljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

d) Kryen, së bashku me grupin negociator të Republikës së Shqipërisë dhe në drejtim të tij, negociatat teknike të anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të gjithë grup-kapitujt (*clusters*) dhe kapitujt negociues, si dhe bashkërendon punën për përgatitjen e institucioneve shqiptare;

dh) Bashkërendon punën për kontributin nga negociatat teknike e grupit negociator të Republikës së Shqipërisë në procesin e përgatitjes nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Traktatit të Anëtarësimit (dhe akteve e dokumentacionit shoqërues) në Bashkimin Evropian;

e) Bashkërendon punën e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe ndjek ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera;

ë) Bashkërendon hartimin e agjendës së reformave në të gjithë sektorët, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

f) Bashkërendon dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian nga institucionet shqiptare, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

g) Bashkërendon dhe nxit nismat e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera në lidhje me integrimin e përshpejtuar (gradual), me fokus, veçanërisht, në institucionet e Bashkimit Evropian dhe Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian;

gj) Propozon projektakte, që kanë lidhje me procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

h) Nxit dhe mbështet ngritjen e mekanizmave metodologjikë, platformave, instrumenteve dhe mjeteve të lidhura me negociatat dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si dhe për politikat publike dhe reformat, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

i) Bashkërendon punën për zhvillimin e kapaciteteve dhe mbështetjes për institucionet shqiptare për procesin e negociatave dhe



anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe politikëbërjen;

j) Bashkërendon punën për hartimin e kuadrit, si dhe zbatimin nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të programeve e të nismave për informimin e publikut për çështjet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

4. Vendimi nr. 517, datë 29.7.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 522, datë 25.9.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit.

3. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave për:

i. zbatimin e reformës tërësore në administratën publike, përfshirë këtu menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike dhe sistemin e pagave, zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe promovimin e inovacionit në administratën publike;

ii. çdo ndërhyrje tjetër në zbatim të reformës në administratën publike;

b) Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

4. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj, me akte të Këshillit të Ministrave dhe nga Kryeministri.

5. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe bashkëdrejtues i Komitetit Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

6. Vendimi nr. 29, datë 17.1.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 523, datë 25.9.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Miratimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas këtij vendimi.

II. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave, ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e qeverisë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (në vijim “Kuvendi”), për:

a) hartimin dhe miratimin e programit të punës e të kalendarit të punimeve të Kuvendit;

b) procesin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave, si dhe dërgimin e të dhënave, apo të informacioneve, gjatë procesit ligjbërës të Kuvendit;

c) seancat e pyetjeve, interpelancat, petitionet, si dhe kontrollin që ushtrojnë komisionet e përhershme parlamentare mbi ministrinë përgjegjëse apo autoritetet përgjegjëse të administratës shtetërore.

2. Përgatit dokumente apo mendime vlerësuese për projektaktet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave. Bashkërendon, nëse nevojitet, veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, ministrive, apo autoriteteve përgjegjëse shtetërore me institucionet e pavarura.

3. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në marrëdhëniet e informimit të publikut për vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave.

III. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjesisë, sipas pikës 1, të ndarjes II, të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Merr pjesë në mbledhjen e konferencës së kryetarëve të Kuvendit.

2. Bashkërendon programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit me programin politik të Këshillit të Ministrave.

3. Informon vazhdimisht dhe në kohë Kryeministrin, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për programin dhe kalendarin e procesit ligjbërës të Kuvendit, si dhe për aktivitetet e tjera të tij.

4. Ndjek në mënyrë periodike ecurinë e procesit ligjbërës në Kuvend, nëpërmjet procesverbaleve dhe relacioneve që përpunohen gjatë shqyrtimit të

projektligjeve dhe informon Kryeministrin për problematikat që mund të dalin gjatë këtij procesi.

5. Bashkërendon punën për pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Ministrave në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit.

6. Kujdeset për dërgimin në komisionet e Kuvendit të relacioneve, të të dhënave apo dhe të informacioneve të kërkuara nga ministrinë apo autoritetet përgjegjëse shtetërore gjatë procesit të:

a) shqyrtimit të një projektligji;

b) zhvillimit të një procedure pyetjesh, interpelance apo shqyrtimi të një peticioni.

7. Ndjek ecurinë në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve:

a) duke bashkërenduar punën dhe duke u kujdesur për dërgimin pranë komisionit përkatës të Kuvendit të mendimeve nga ministria, në fushën e përgjegjesisë të së cilës është projektligji;

b) duke vlerësuar nëse përmbajtja e tyre harmonizohet me programin politik të Këshillit të Ministrave;

c) duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Financave për analizën për koston financiare që ka projektligji për buxhetin e shtetit, nëse do të ketë një efekt të tillë.

8. Njofton Kryeministrin për problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve.

9. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit, ku shqyrtohen projektligje apo akte normative të ndërmarra me nismën e Kryeministrit.

10. Ndjek, së bashku me drejtuesit e institucioneve të pavarura, shqyrtimin në Kuvend të projektligjeve, që trajtojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

11. Kujdeset dhe bashkërendon procesin e një kontrolli parlamentar të ndërmarre nga komisionet e Kuvendit me ministrinë apo autoritetin përgjegjës të administratës shtetërore, i cili është subjekt i kontrollit.

12. Bashkërendon punën dhe bashkëpunon me kryetarët e grupeve parlamentare për ecurinë e procesit ligjbërës.

13. Bashkërendon punën me kryetarin e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për hartimin e kalendarit të seancave për pyetje, interpelanca, mocione të besimit apo mosbesimit.



14. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në institucionet e ndryshme për paraqitjen e programit e të kalendarit të punimeve të Kuvendit, si dhe të përparësive të politikave të qeverisë.

15. Kujdeset për kryerjen e detyrave për përcjelljen në Kuvend të projektakteve normative.

16. Kujdeset dhe ndjek procedurat për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të emërimeve që paraqiten me propozimin e Këshillit të Ministrave apo të ministrave përgjegjës.

IV. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 2, të ndarjes II, të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Përgatit bashkërisht me ministrinë e interesuara dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave mendimin me shkrim për projektligjet e ndërmarra me nismën e një deputeti, apo njëzet mijë zgjedhësve.

2. Nëse e vlerëson të nevojshme, jep mendim me shkrim për projektakte të veçanta, gjatë fazës së bashkërendimit të tyre, për përputhshmërinë e tyre me:

a) Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) programin politik të Këshillit të Ministrave;

c) kërkesat apo opinionet e dokumenteve politike dhe të raporteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integritetit evropian.

3. Paraqet në Këshillin e Ministrave analiza, raporte, vlerësime apo rekomandime, të përgatitura nga grupe pune të ngritura me urdhër të Kryeministrit, në lidhje me zbatueshmërinë e normave juridike të caktuara, apo për projektakte, të cilat synojnë zbatimin e reformave të rëndësishme, sipas programit të qeverisë.

4. Drejton ose bashkërendon veprimtarinë e grupeve ndërminstrore apo ndërinstucionale të punës për përgatitjen, apo vlerësimin e projektakteve, sa herë që kjo i caktohet me urdhër të Kryeministrit.

5. Realizon, kur është e nevojshme, konsultime me grupe interesi, shoqërinë civile dhe/ose përfaqësues të ministrive, institucioneve të pavarura apo autoriteteve shtetërore përgjegjëse për projektligje të ndryshme dhe informon Këshillin e Ministrave në lidhje me këto konsultime.

6. Bashkërendon punën dhe trajton shqetësimet që kanë institucionet e pavarura, apo institucione të tjera në lidhje me:

a) marrëdhëniet institucionale që ato kanë me Këshillin e Ministrave, ministrinë apo autoritete të ndryshme shtetërore përgjegjëse;

b) hartimin e projektakteve që trajtojnë organizimin dhe funksionimin e tyre;

c) interesa të tjerë që ato kanë për projektakte të ndryshme apo për procesin ligjvënës.

7. Kujdeset për dërgimin në Kuvend të përgjigjeve të përgatitura nga ministrinë apo autoritetet shtetërore përgjegjëse për kërkesat për të dhëna dhe informacione gjatë procesit të shqyrtimit të një projektligji apo gjatë një procedure parlamentare pyetjesh apo peticioni.

8. Kujdeset për respektimin e procedurave dhe të afateve ligjore për emërimet që i propozohen Kuvendit nga Këshilli i Ministrave apo ministri përgjegjës.

9. Promovon, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave, realizimin e objektivave parësorë të qeverisë.

V. Ministri i Shtetit, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të ndarjes II, të këtij vendimi, ushtron kompetencat e zëdhënësit të Këshillit të Ministrave për informimin e vendimmarrjeve më të rëndësishme të tij, si dhe për ato me interes për publikun.

VI. Vendimi nr. 27, datë 23.1.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin”, shfuqizohet.

VII. Ngarkohet ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 525, datë 25.9.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Z. Andi Mahila, zëvendësministër i Brendshëm, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 526, datë 25.9.2025

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Silva Caka emërohet zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 527, datë 25.9.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Mira Kapisyzi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 528, datë 25.9.2025

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Eugena Tomini emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 529, datë 25.9.2025

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Edona Bilali emërohet zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 539, datë 25.9.2025****PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË
KRYETARIT TË BASHKISË TIRANË,
Z. ERION VELIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 62, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë Tiranë, shkarkohet nga kjo detyrë, me propozimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, miratuar me vendimin nr. 69, datë 23.9.2025.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

